

## RELACION

### PËR

# PROJEKT-VENDIMIN PËR PROPOZIMIN E PROJEKT-LIGJIT “PËR HUAMARRJEN SHTETËRORE, BORXHIN SHTETËROR DHE GARANCITË SHTETËRORE TË HUASË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

## I. QËLLIMI I PROJEKT-LIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për Huamarrjen Shtetërore, Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore të Huasë në Republikën e Shqipërisë” synon realizimin e disa ndërhyrjeve të nevojshme në ligjin që rregullon borxhin shtetëror të Republikës së Shqipërisë”. Ligji i synuar nuk është një ligj i ri, por ligj ekzistues, i krijuar në vitin 2006, dhe i cili ka pësuar vetëm një herë ndryshime, në vitin 2014.

Ligji u ripunua si një ligj i ri dhe jo si ligj ndryshues për të rregulluar gjithashtu formën e tij në tërësi në përputhje me teknikën legjislativë, duke qënë një ligj i vjetër në kohë. Konkretisht nenet e ligjit sikundër është aktualisht janë të ndarë në paragrafë të pa numërtuar. Ky lloj organizimi vjen në kundërshtim me rregullat e teknikes legjislativë dhe krijon probleme gjatë zbatimit të ligjit kur nevojitet referenca ndaj pjesëve të caktuara të tij.

Nevoja për ndryshimin e ligjit lindi nga një sërë problematikash e vështirësish të ndodhura pas emetimit, në kushtet e emergjencës së shkaktuar nga pandemia COVID-19, të dy Garancive Sovrane për ti ardhur në ndihmë bizneseve të prekura.

Për të adresuar një sërë shqetësimesh që lindën në lidhje me administrimin e këtyre skemave, në kushtet ku strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nuk kanë kapacitetet për administrimin e një sërë aspektesh, si:

- verifikimi i rasteve të thirjes së garancisë;

- rikuperimin e të drejtave që i linden MFE pas çdo pagese në kuadër të garancive të lëshuara,

lindi nevoja që këto funksione, t'i kalohen një strukturë, që është nën varësinë e MFE dhe që ka ekspertizën e nevojshme në këtë drejtim, konkretisht, Agjencia e Trajtimit të Kredive (ATK).

Në këtë mënyrë, në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë bërë një sërë ndryshimesh, të cilat në radhë të parë akomodojnë rregullimet e nevojshme për ti kaluar në ndjekje ATK-së një sërë funksionesh për menaxhimin e skemave të Garancive Sovrane, këto të lëshuara për ti ardhur në ndihmë biznesit në situatën e Covid 19, apo çdo skemë të ngjashme që mund të jetë e nevojshme në të ardhmen të miratohet.

Përveç ndryshimeve në këtë drejtim, në ligj janë bërë edhe disa ndërhyrje të tjera në drejtim të përmirësimit të tij në funksion të veprimtarisë së huamarrjes shtetërore dhe të menaxhimit të borxhit shtetëror.

Një ndryshim ligjor i rëndësishëm që synohet gjithashtu lidhet me kalimin të ATK e funksionit të rikuperimit të të drejtave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë referuar edhe Garancive Shtetërore apo Marrëveshjeve të Nënhuave nga të cilat përfitojnë subjekte publike apo ndërmarrje shtetërore siç janë operatorët e energjisë, ujësjellësat etj., pra duke mundësuar rikuperimin e të drejtave edhe përtej skemave të veçanta të garancive, duke qënë se ATK gëzon ekspertizën e nevojshme për ta bërë këtë.

Cështja e mbledhjes së detyrimeve nga këto subjekte kundrejt buxhetit të shtetit është një problem që i është kushtuar vëmendje e veçantë gjatë auditimeve të KLSH, si dhe është pjesë e raporteve të lëshuara nga ky institucion, ndaj konsiderohet mëse e nevojshme ndërmarrja e gjithë masave të mundshme në këtë drejtim, duke përfshirë këtu edhe ndryshime të nevojshme ligjore.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektligji i propozuar nuk është i parashikuar në programin analitik të akteve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të parashikuara për t'u miratuar nga ana e Këshillit të Ministrave për vitin 2021, por nga rëndësia që paraqet për mbarëvajtjen e procesit të menaxhimit të borxhit shtetëror dhe garancive shtetërore të huasë nevojitet miratimi i tij sa më parë gjatë vitit 2021.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë bërë një sërë ndryshimesh, të cilat në radhë të parë akomodojnë rregullimet e nevojshme për ti kaluar në ndjekje ATK-së një sërë funksionesh për menaxhimin e skemave të Garancive Sovrane, këto të lëshuara për ti ardhur në ndihmë biznesit në situatën e Covid 19, apo çdo skemë të ngjashme që mund të jetë e nevojshme në të ardhmen të miratohet. Në këtë kontekst, ATK-së, nëpërmjet ndryshimeve ligjore të propozuara i kalojnë për t'u menaxhuar aktivitetet/funksionet e mëposhtme:

- Administrimi dhe ruajtja e dokumentacionit dhe të dhënave sa i takon skemave të garancive, pa cënuar detyrimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për ruajtjen e dokumentacionit dhe regjistrimin e të dhënave për borxhin shtetëror dhe garancive shtetërore të huave;
- Mbajtja e bazës së të dhënave dhe regjistrin analitik të garancive që menaxhon;
- Verifikimi i rasteve të thirjes së Garancisë për pagesë, në rastet e mospagimit nga Huamarrësi dhe njoftimi i MFE;
- Ndjekja e rikuperimit të të drejtave që i lindin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë pas pagesave të kryera sipas skemave të garancisë;
- Raportimi në MFE

Në projekt-ligjin e propozuar synohet të shtohet një nen mbi ***Qëllimin e lëshimit të garancisë shtetërore të huasë***, si më poshtë, në vijim të nenit që përcakton ***Qëllimin e marrjes së borxhit***. Në këtë mënyrë, sipas projekt-ligjit të propozuar:

*“Ministri përgjegjës për financat, në emër të Këshilli i Ministrave lëshon garanci shtetërore të huasë:*

- a) Për të mbështetur politikat zhvillimore të sektorëve të ekonomisë;*
- b) Për të mbështetur kreditimin e ndërmarrjeve shtetërore më rëndësi strategjike me qëllim realizimin e projekteve të investimeve nga këto ndërmarrje;*
- c) Për të mbështetur kreditimin e ndërmarrjeve private, në zbatim të politikave të veçanta të Qeverisë. Në këtë rast mund të përdoren skema të veçanta kolektive të garancive shtetërore. Menaxhimi i disa aspekteve të këtyre skemave të veçanta të garancive, duke përfshirë por pa u kufizuar në, shqyrtimin, vlerësimin dhe miratimin i aplikimeve/kërkesave për garanci, dokumentacioni, mbikqyrja dhe ndjekja e kthimit të garancisë, do të mundësohet nga një institucion i caktuar me ligj për kryerjen e këtyre funksioneve (referuar në këtë ligj si “institucioni i caktuar me ligj për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive”);*
- d) Për të mbështetur masat që mund të ndërmerren në rastet e ndonjë krize të sistemit financiar;*
- e) Për të mbështetur ristrukturimin e portofolit ekzistues të garancive shtetërore të huasë me qëllim reduktimin e nivelit të riskut.”*

Gjithashtu, referuar pjesës së ligjit që rregullon Dhënien e garancisë shtetërore të huasë, shtohet një nen i posaçëm që rregullon lëshimin e Skemave të veçanta të garancive si më poshtë, parashikim i cili është në të njëjtën linjë me lëshimin e garancive sovrane të zakonshme:

*“1. Në rastin e skemave të veçanta të garancive, të cilat menaxhohen nga institucion i caktuar me ligj për këtë qëllim, Ministri përgjegjës për financat miraton:*

- a) termat kryesore të huasë ndërmjet institucionit huadhënës dhe huamarrësit;*

Relacion shpjegues për “Projektvendimin për propozimin e projektligjit “Për Huamarrjen Shtetërore, Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore të Huasë në Republikën e Shqipërisë”.

b) projekt marrëveshjen e garancisë ndërmjet institucionit huadhënës dhe shtetit;

c) projekt marrëveshjen tip të mirëkuptimit, që do të nënshkruarhet nga huamarrësi

2. *Nënshkrimi i marrëveshjes së garancisë dhe i marrëveshjes së mirëkuptimit bëhen në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.*”

Sa i takon ndryshimeve në kuadër të menaxhimit të skemave të veçanta të garancive shtetërore, sqarojmë sa vijon.

Në rastin e skemave të veçanta të garancive, mbikëqyrja e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë përfituar nga skema e garancisë do të kryhet nga ATK dhe kjo e fundit do të kryejë edhe verifikimin e rasteve kur kërkohet pagesë nga garancia shtetërore.

ATK, në emër të MFE do të ndërmarrë të gjitha masat e paracaktuara në këtë ligj, në ligje të tjera në fuqi dhe në marrëveshjet e mirëkuptimit, për rikuperimin e garancisë të përftuar nga huamarrësi çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë edhe kostot që lidhen me të, referuar të gjitha garancive shtetërore të lëshuara sipas objektit të këtij ligji, dhe garancive të tjera të lëshuara para hyrjes në fuqi të tij. Ndryshimi në ligj synon të rregullojë edhe rekuperimin e të drejtave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në kuadër të marrëveshjeve të nënhuasë, ku serish funksioni i rekuperimit të këtyre të drejtave do të kalohet ATK.

ATK do të mbajë dhe administrojë të dhënat dhe dokumentacionin që lidhen me skemat e veçanta të garancisë, pa çënuar detyrimin e MFE për administrimin e të dhënave të borxhit dhe garancive shtetërore.

ATK do të raportojë rregullisht pranë MFE të dhënat e regjistrit për garancitë që do të menaxhojnë, si dhe do të dokumentojë përfundimin e garancisë referuar skemave të veçanta të garancive.

Ndryshimet ligjore gjithashtu përfshijnë disa modifikime të nevojshme në kuadër të rekomandimeve të lëna nga KLSH në raportet e auditimit të kryera në Drejtorinë e Borxhit Publik, dhe të cilat kryesisht synojnë shtimin e instrumenteve/

---

Relacion shpjegues për “Projektvendimin për propozimin e projektligjit “Për Huamarrjen Shtetërore, Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore të Huasë në Republikën e Shqipërisë”.

mekanizmave ligjore për mbledhjen e të drejtave që i linden MFE në kuadër të marrëveshjeve të nënshkrimit dhe garancive.

Një sërë ndryshimesh të tjera synohen në ligj, në drejtim të përmirësimit të tij, të sqaruara si më poshtë:

- ✓ Në ligj synohet të ndryshohet një parashikim i cili vjen në kundërshtim me marrëveshjet ndërkombëtare të garancive shtetërore. Sipas parashikimeve aktuale të ligjit, *Kur huamarrësi s'ka mundur të bëjë pagesën/pagesat, në përputhje me kushtet dhe afatet e marrëveshjes së huasë, të përcaktuara për këtë qëllim dhe institucioni huadhënës vërteton se ka marrë të gjitha masat e nevojshme, siç përcaktohet në këtë ligj dhe në marrëveshjen e garancisë, për të marrë në dorëzim pagesën/pagesat e premtuara, institucioni huadhënës i paraqet Ministrin e Financave një kërkesë për pagesë, në përmbushje të së drejtës së tij, sipas garancisë shtetërore të huasë. Ministri i Financave, pasi vëren se kërkesa për pagesë është në përputhje me kushtet që bëjnë të nevojshme paraqitjen e një kërkesë të tillë, sipas përcaktimeve të marrëveshjes së huasë, autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për institucionin huadhënës brenda pesëmbëdhjetë ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës.*

Ndërkohë, marrëveshjet e garancive të lidhura, ndryshe nga sa parashikon ligji, parashikojnë që MFE duhet të paguajë në okhë detyrimin që nuk e paguan huamarrësi. Të vepruarit sikundër parashikon ligji, do të conte në shkelje të marrëveshjeve ndërkombëtare të garancive shtetërore. Në këtë mënyrë, u riformulua neni përkatës si vijon, për të siguruar një përputhshmëri maksimale të kuadrit tonë ligjor, me marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen në këtë fushë. Paragrafi i rishikuar i ligjit paraqitet si vijon:

*“1. Kur huamarrësi nuk ka mundësi të kryejë pagesën/pagesat, në përputhje me kushtet dhe afatet e marrëveshjes së huasë, të përcaktuara për këtë qëllim, njofton menjëherë Ministrinë përgjegjëse për financat. Pas këtij njoftimi, Ministria përgjegjëse për financat verifikon paaftësinë paguese të huamarrësit. Për kryerjen e këtij verifikimi, Ministria përgjegjëse për financat është e*

*autorizuar të kërkojë dhe të marrë nga bankat informacion mbi gjendjen e llogarive bankare të subjekteve përfituese të garancisë.*

*2. Kërkesa për pagesë mund t'i vijë Ministrisë përgjegjëse për financat edhe nga institucioni huadhënës.”*

Ky paragraf është plotësuar edhe me një sërë parashikimesh si vijojnë, në kuadër të zgjerimit të instrumenteve të MFE në mbledhjen e të drejtave referuar pagesave të kryera nga Garancitë. Gjithësesi kryerja e pagesës sipas Marrëveshjes përkatëse të Garancisë nuk mund të kushtëzohet nga këto masa që ndërmer MFE, përndryshe do të rezultonte në mospërmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshjet e Garancisë:

*“3. Në zbatim të detyrimeve që lindin nga marrëveshja e garancisë, me marrjen e njoftimit/kërkesës të lartpërmendur, Ministri përgjegjës për financat, autorizon kryerjen e pagesës në përputhje me përcaktimet e marrëveshjeve të huasë dhe garancisë. Kryerja e pagesës kryhet përpara dhe pavarësisht rezultatit të verifikimit të aftësisë paguese të huamarrësve.*

*4. Pas kryerjes së pagesës, në rast se nga verifikimi i aftësisë paguese të huamarrësve rezulton se ka mundësi pagese, Ministria përgjegjëse për financat, me Urdhër kërkon bllokimin e llogarive dhe sekuestrimin e kundravleftës që ajo ka paguar. Njëkohësisht, ngarkohet Ministri përgjegjës për financat të marrë masat administrative në bazë të legjislacionit në fuqi, në rast të konstatimit të mospagesës nga keqadministrimi i përfituesve të garancisë.*

*5. Urdhëri i Ministrit përgjegjës për financat sipas pikës 4, të këtij neni përbën titull ekzekutiv.”*

Sa i takon skemave të veçanta të garancisë, parashikimi për këtë çështje është formuluar si vijon:

*“6. Në rastin e skemave të veçanta të garancisë, kërkesa për pagesë i drejtohet institucionit të caktuar me ligj për administrimin e skemave të veçanta të garancisë, në përputhje me marrëveshjen e huasë dhe të garancisë, ku ky i fundit kryen verifikimin e përputhshmërisë së kërkesës për pagesë me kushtet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë dhe garancisë. Institucioni i caktuar me*

---

Relacion shpjegues për “Projektvendimin për propozimin e projektligjit “Për Huamarrjen Shtetërore, Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore të Huasë në Republikën e Shqipërisë”.

*ligj për administrimin e skemave të veçanta të garancisë përcjell kërkesën për pagesë pranë Ministrisë përgjegjëse për financat në kohë, për të mundësuar pagesën brenda afateve të parashikuara në marrëveshje.”*

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ndryshimet e propozuara në tërësi janë në përputhje të plotë me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Projektvendimi i propozuar mbështetet në nenet 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, ndërsa Projektligji i propozuar mbështetet në nenet 78, 83 pika 1 dhe 156 të Kushtetutës.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVE).**

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT**

Projektligji i propozuar përmban 54 nene, nga të cilat dy janë nene të shtuara ndërsa të tjerat janë nene ekzistuese të ligjit, ku janë reflektuar ndryshime të nevojshme për sa parashtrohet në sesionin III të këtij relacioni.

#### **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E AKTIT.**

Me zbatimin e këtij akti ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e tjera që kanë detyrime në përputhje me parashikimet e ligjit “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancisë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”.



## **VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT DHE QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT**

Ky projektligj dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ndryshimet e propozuara nuk kanë efekte financiare për buxhetin e shtetit.

**MINISTRI I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË**

**ANILA DENAJ**